

PROBLEME DHE PROPOZIME MBI LEGJISLACIONIN SHQIPTAR QE KA TE BEJE ME ORGANIZATAT JO-FITIMPRURESE

I. LEGJISLACIONI I VECANTE I OJF-VE

Dispozita ne lidhje me regjistrimin dhe regjistrin e OJF-ve

Aktualisht, regjistrim i organizatave jofitimpruese eshte i perqendruar vetem ne Tirane, ku informacion i per regjistrimin e OJF-ve perfshihet ne regjistrin tregtar te shoqerive tregtare te krijuara ne baze te Ligjit per shoqerite tregtare dhe te regjistruara ne baze te Ligjit per Regjistrin Tregtar. Kjo praktike duhet te ndryshohet nepermjet decentralizimit te regjistrimit te OJF-ve. Me tej, decentralizim i regjistrimit duhet te shoqerohet nga kompjuterizim i sistemit te dhenave mb i OJF ne menyre qe informacion i te jete i aksesueshem nga cdo rreth dhe te permbaje te dhena mb i OJF-te e cdo rreth i te vendit. Gjithashtu, duhet te rregullohet ne menyre te shprehur ne ligj personalitet i juridik i degeve te OJF-ve te krijuara dhe regjistruara ne Shqiperi.

Ligj i per regjistrimin e OJF-ve nuk percakton arsyet dhe shkaqet ne baze te cilave gjykata mund te refuzojne regjistrimin. Nen i 25 duhet te rishikohet per te percaktuar kriteret per refuzimin e regjistrimit.

Gjykatat tona der i tan i kane hasur veshtiresi ne kryerjen e procedurave te crregjistrimit dhe likujdimit te OJF-se dhe kjo eshte pasuar me mbajtjen e qendrimeve te ndryshme per kerkesa te njejta. Ne keto kushte, unifikim i praktikes per procedurat e crregjistrimit dhe likujdimit te OJF-ve eshte i domosdoshem. Detajim i dispozitave perkatese ne ligj do te ndihmonte procesin e unifikimit.

Nje sugjerim tjetër ka lidhje me regjistrimin e selise se OJF. Ky informacion është i rëndësishëm jo vetëm për efektet e formalizimit të vetë OJF-ve por, edhe për të dhënat që të tretet marrin nga ky regjister. Ligji aktual nuk përcakton asnjë sanksion për mosplotësimin e këtij detyrim i dhe gjithashtu ndoshta ka nevojë për qartësim edhe kur bëhet fjalë për elemente që ndryshojnë dhe sipas tij duhet “depozitohen” si p.sh. pjesë e statutit të OJF (drejtori, bordi i drejtoreve, etj).

Dispozita në lidhje me veprimtarinë e OJF-ve

Duket se përcaktimi i një statusi të qartë të Qendrave në radhën e formave ligjore të OJF-ve në dallim nga format e tjera të OJF-ve është i nevojshëm për të evituar kryerjen e veprimtarisë së mirefillte fitimprurëse, si veprimtari i pasesorë e saj. Gjithashtu duhet të qartësohet praktika e licencimit të OJF-ve. Si shembull për rregullimin e praktikës mund të përdoret praktika gjyqësore e licencimit për shoqëritë tregtare.

Ligji për OJF-te, ngarkon disa ministri për nxjerrjen e akteve nenligjore, por këto të fundit ende nuk e kanë plotësuar këtë detyrim ligjor. Në këto kushte, nga Ministrinë përkatëse kërkohet që të përgatiten aktet nenligjore në lidhje me transferimin e dosjeve në gjykatën e Tiranës dhe mbijetesat e pagesat e regjistrimit të OJF-ve nga Ministria e Drejtësisë si dhe për licencimin e OJF-ve nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale

Duke vlerësuar se përmirësimi i transparencës së OJF-ve është mjaft i rëndësishëm për rritjen e emrit të mirë të vetë sektorit, përcaktimi i detyrimeve ligjore për transparencën e OJF-ve do të shërbente këtij qëllimi. Për këtë mund të vendosej detyrim për p.sh. botimin e raporteve vjetore, etj.

Gjithashtu sugjerohet që një perkufizim më i gjërë e më plotë për OJF-te. Sugjerohet që entet jo fitimprurëse të klasifikohen duke u bazuar në kategoritë juridike të përgjithshme të enteve si akti i themelimit që deklaron ekzistencën, qëllimet institucionale, aktivitetin si dhe shpërndarjen e entit jo fitimprurës; natyrën juridike private të entit; instrumentet e qeverisjes mbijetesat e grupit; mosshpërndarja e fitimeve; prezencën e një komponenti të punës vullnetare.

Gjithashtu disa kritere që mund të merren në konsideratë në klasifikimin si OJQ duhet të jenë:

- marrësit e produkteve dhe shërbimeve të shpërndara nga OJQ-te;
- drejta e kontrollit mbijetesat e pronës;
- diferenca pozitive ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve që do të investohet në aktivitetet dhe që nuk do të përfaqëson fitim;
- cmimi i produkteve që garanton të pakten mbulimin e kostove;

- perdorim i fitimit te realizuar per tu rinvestuar ne permiresimin te cilesise dhe dimensioneve te aktivitetit, duke lejuar per me teper te realizoje qellimin social te statutit. furnizimin me te mira materiale dhe sherbime me dob i shoqerore me kushte te ndryshme nga ato te ofruara nga ente te tjera fitim prures
- futjen ne rregulloren e vet organizative persona me kushte te kufizuara, me disavantazhe (te meta te kufizuara mendore e fizike etj).

Nje kusht i domosdoshem eshte qe duhet te percaktohen qarte kriteret juridike dhe ekonomike qe e dallojne nje NGO qe mund te perfshihet ne veprimtar i ekonomike jofitim prures nga subjektet e tjera qe kryejne te njejten veprimtar i ekonomike por per qellim fitim prures (p.sh. ne fushen e arsimit, shkollat, apo ne fushen shendetsise – klinikat e analizave dhe vizitave mjeksore, etj).

Lind nevoja per standartizimin e te gjitha formave dhe aplikimeve qe percaktohen ne ligj (kerkesa per regjistrim, ndryshimet ne statut – anetaresi.). Ne lidhje me kete do te ishte e keshillueshme qe ne Ligjin per OJF te kishte nje klauzole qe te detyronte brenda nje afat i te caktuar institucionet respektive t' i nxirrnin ato.

Pervec kesaj ka nje seri nesh sidomos ne ligjin e regjistrimit qe I kerkon gjykates te marr i vendim brenda nje afat i te caktuar, por nuk thote se cfare ndodh ne rast se gjykata nuk e ben kete. Ne ligj mund te shtohet qe vendim i per regjistrim apo per depozitimin e ndryshimeve quhet s i i marre ne rast se gjyqtar i nuk vepron brenda afatit 15 ditor.

II. LEGJISLACIONI MBI VEPRIMTARINË FINANCIARE DHE TATIMORE TE OJF

Dispozita ne lidhje me veprimtarine ekonomike

Ndryshimet e propozuara nga grupi I punes ne lidhje me Legjislacionin mbi veprimtarine financiare dhe ate tatimore te OJF-ve jane si me poshte:

Dispozitat ligjore duhet te perjashtojne shperndarjen e te ardhurave neto apo te fitimit nga aktiviteti ekonomik i nje OJF-je, tek cdo person, pasi mund te ndodhe qe OJF-ja te regjistrohet me qellimin e per te shperndare fitimet tek palet e treta duke pretenduar se kjo eshte e lejueshme.

Duhet te vendoset qarte ne ligj qe anetareve te organeve drejtuese vendimmarrese dhe ekzekutive: (i) u paguhen paga te arsyeshme –(ii) u rimbursohen shpenzimet qe behen per OJF-ne; (iii) ne raste jo te vazhdueshme, kur kryen takime apo ore shtese, anetaret e bordit marrin shperblime te arsyeshme dhe,

ne rast te puneve shtese, ata paguhen me pagese jo me te larte se vlera e tregut; (iv) anetaret e organeve drejtuese vendimarrese dhe ekzekutive nuk mund te perfitojne te mira ne menyre direkte ose indirekte nga shoqata

Duhet ripare neni 39 i Ligjit per OJF ne lidhje me pjesmarrjen ne tenderime e OJF-ve nen driten e respektimit te ligjit te konkurrences dhe parimit te konkurrences se drejte pasi OJF-te mund te kene oferta me te uleta meqenese jane jo-fitimprurese.

Neni 40 i ligjit per OJF-te percakton perjashtimin nga tatimi mbi te ardhurat qe realizohen nga dhurimet dhe kuotat e anetaresise. Duhet te behet nje percaktim i metejshe i llojit te te ardhurave te OJQ-ve qe do te perjashtohen ose jo sipas nj eliste te detajuar.

Duhet qe te behet nje percaktim shume i qarte ne statut se cili eshte aktiviteti kryesor i OJF-s, apo te ndahet qe ne statut aktiviteti jo-fitimprures nga ai ekonomik. Subjekt i tatim fitimit duhet te jene te gjitha fitimet qe rrjedhin nga aktiviteti ekonomik i OJF-se si dhe te te ardhurat nga reklamat si dhe nuk duhet te jene subjekt i tatim fitimit te gjitha te ardhurat nga aktiviteti paresor i OJF. Per kete duhet te biem dakord qe per nje OJF, veprimtaria paresore eshte ajo ne interes te publikut dhe veprimtaria ekonomike fitimprurese eshte veprimtaria dytesore.

Dispozita ne lidhje me veprimtarine financiare te OJF-ve

Ne ligj duhet te vendosen kufizime per madhesine e veprimtarise ekonomike fitimprurese qe mund te kryeje nje OJF. Gjithashtu duhet te sanksionohet lejimi i grumbullimit te nje fondi per perdorim te ardhshem per veprimtarine jofitimprurese te OJF-se;

Ligji duhet te permbaje parashikime qe detyrojne qe gjate hartimit te buxheteve te pushtetit vendor te krijohen hapesira per akordime te drejtperdrejta per OJF-te. Nje pjese e taksave te mbledhura (e shprehur ne perqindje, etj) te jepet ne forme donacionesh per organizatat qe ofrojne sherbime.

Ligji duhet te permbaje parashikime te cilat te detyrojne qe fondet shteterore te vena ne dispozicion te strukturave shteterore (te perfshira ne buxhetin e miratuar te shtetit) dhe te paperdorura nga keto te fundit, te vihen ne dispozicion te OJF-ve. Keto parashikime duhet te ndiqen nga parashikime se cili organ do te beje shperndarjen, cfare kriteresh do te perdoren per shperndarjen, etj.

Ligji per kontabilitetin te perfshije rregulla te vecanta per mbajtjen e llogarive nga OJF-te. Te mos kete njesime te detyrimeve per mbajtjen e llogarive nga subjektet tregtare me ato jofitimprurese.

Dispozita ne lidhje me veprimtarine tatimore te OJF-ve

I gjithë legjislacioni tatimor nuk e ka të konsoliduar konceptimin mbi organizatat jofitimpruese. Po kështu, nga vlerësimi i dispozitave të legjislacionit, vëre re se mungon kuptimi i përgjithshëm se ndaj këtyre subjekteve duhet të zbatohet një regjim dhe procedura të vecanta tatimore. Pasqyrimi i këtij ndryshimi duhet të bëhet në të gjithë legjislacionin tatimor.

Percaktimi i rregjimit fiskal për organizatat që mund të ushtrojne edhe veprimtari mix, pra që mund të realizojne fitime por që nuk e shpërndajne ato dhe e perdorin për interes publik sipas statutit.

Perqindja e tatimit mbi fitimin (për veprimtari ekonomike) të jetë me e ulët (mund të aplikohen masa të ndryshme tatimi në varësi të fitimit të realizuar). Gjithsesi, kjo duhet parë në dritën që të mos cenohet zbatimi i parimeve të konkurrencës së drejtë midis subjekteve tregtare dhe subjekteve jofitimpruese që ushtrojne veprimtari ekonomike në biznese të njëjta. Po kështu, duhet mbajtur në kujtesë se perqindja me e ulët e tatimit mund të lere vend për abuzime serioze duke lene shteg që veprimtari të mirefillta fitimpruese të regjistrohen si OJF.

Procedurat e përjashtimit (ose e vertetimit të përjashtimit) nga detyrimet tatimore të mos jënë të komplikuar dhe, njëkohësisht, të jënë të zbatueshme. Ndjekja e procedurave perkatese duhet të jënë efektive dhe në mënyrë që të bëjnë të kapshëm dhe të përdorshëm përfitimin në praktike nga lehtësira tatimore.

Veprimet e OJF-ve me Drejtorinë e Tatimeve duhet të jënë në afatë me të gjatë. Afatet e përcaktuara në legjislacion për qellimet në fjalë janë të shkurtra dhe, përgjithësisht, të kërkueshëm për ekzekutim çdo muaj.

Rimbursimi i TVSH është një nga problemet që po përjetohet sot në Shqipëri si nga subjektet tregtare ashtu edhe OJF-të. Në këto kushte, duhet të kërkohej të zbatohet në praktike rimbursimi i TVSH-së edhe për subjektet OJF. Në diferencën për aplikimin e TVSH-së të zbritet edhe TVSH e paguar edhe për veprimtari ekonomike (shih rastin i Sllovenisë). Gjithashtu sugjerohet që të aplikohen lehtësira tatimore të ndryshme në varësi të formës së OJF-ve; të aplikohen përjashtime tatimore për kontributet në natyrë të marra nga OJF-të si dhe të këtu unifikim të praktikave të organeve tatimore në të gjithë vendin (përjashtojnë sistemin e taksave që janë kompetence e këshillave bashkiake).

Shoqëritë tregtare në bazë të ndryshimeve në ligjin për sponsorizimet gëzojnë lehtësi tatimore deri në 10% të fitimit para tatimit për një sërë aktiviteteve. Duke qenë se deri tani shoqëritë tregtare nuk u ofrohen lehtësira tatimore në rast se donojnë fonde për OJF-të, lind e nevojshme që të kërkohej të bëhen ndryshimet perkatese në ligjin për sponsorizimet pra, të ofrohen lehtësira tatimore edhe për sponsorizim të OJQ-ve për pjesën e aktivitetit të tyre jofitimprues. Qëllimi është nxitja e filantropisë dhe krijimit të bazës së donatoreve brenda vendit.

Ndryshime te tjera te propozuara kane ne fokus ligjin „Per tatimin mbi te ardhurat“ ku mund te shtohet qe te “perjashtohen nga tatimi mbi te ardhurat personale invalidet dhe personat me aftesi te kufizuara te punesuar prane OJF-ve. Gjithashtu mund te perjashtohen nga taksa e tabelës dhe e pastrimit OJF-te qe kane me pak se psh.10,000 Euro te ardhura ne vit.

Duhet percaktuar nje nen i vecante ne ligjet fiskale lidhur me marredheniet fiskale ose raportet qe duhet te vendosen ndermjet organizatave jofitimpruese dhe zyres se tatim taksave per: T.V.SH., Tatimin ne burim, Sigurimet shoqerore, Kontabilitetin.

Hartimi dhe dorezimi i deklaratave vjetore fiskale (llogarite vjetore) si bilanci, inventaret, llogaria e rezultatit apo anekset e bilancit.

Gjithashtu sugjerojme qe ne Udhezimin e Keshillit te Ministrave per Standartet Kombetare te Kontabilitetit te behet nje sqarim i tille qe do ndihmoje OJF-te ne menyre qe ato te jene te detyruara te mbajne kontabilitetin ne menyre te tille qe te ndajne te ardhurat qe lidhen me aktivitetin jofitimprues nga ato qe lidhen me aktivitetin fitimprues. Shpenzimet duhet te mbahen gjithashtu ne menyren qe te identifikohen se cilit aktivitet i takojne.

Per pjesen e aktivitetit jofitimprues OJF-te mund te perdorin pasqyra financiare te thjeshtuara te ndryshme nga standartet sipas formes se miratuar nga Keshilli Kombetar i Kontabilitetit (te sugjerohen formate te thjeshtuara). Ndersa per pjesen e aktivitetit fitimprues ato do te raportojne plotesisht sipas standarteve ne fuqi. Sugjerohet qe OJQ-te te dorezojne pasqyrat financiare ne organet tatimore ne nje afat me te gjate se shoqerite p.sh. brenda dates 31 Maj.

Mbi bazen e referencave te mesiperme sugjerohet qe eshte mire te vendoset nje limit ligjor i tregusve ekonomik per auditimin e NGO, dhe kjo duhet te behet e detyrueshme pasi deri me sot kjo eshte diktuar vetem nga donatoret dhe jo nga legjislacioni per NGO.